



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 30.03.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 15:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

*10. Erjon Muharremaj*

*(anëtar)*

*11. Marçela Shehu*

*(anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Mbledhja plenare e datës 30 mars 2020 fillon me prezantimin e 4 pikave të rendit të ditës nga ana e Kryetares së Këshillit, zonjës Naureda Llagami, duke filluar me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës; duke vijuar më pas me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, përgatitur edhe ky projektvendim nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës; më pas me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e nismës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë”, përgatitur nga Komisioni Përkohshëm i ngritur për këtë qëllim; dhe duke përfunduar me caktimin e Komisionit që do të përgatisë komentet për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021”.

Pas prezantimit të rendit të ditës, i jepet fjala zotit Ilir Toska, relator për çështjen e parë të rendit të ditës.

Zoti Toska fillimisht propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht do të hidhet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, do të vijojë shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, më pas për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, më pas për Gjykatën e Apelit Korçë dhe në fund për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, konkretisht: znj. Alma Kolgjoka.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik, i cili mundësohet nga specialistë të Misionit EURALIUS dhe nga specialiste znj. Valbona Bako.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Engjellushe Tahiri, e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, ku njëra është në lëndë civile dhe tjetra në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: z. Arben Dosti.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Suela Dashi, e cila caktohet për të gjykuar 2 çështjet e veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, të dyja në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (çështja nr. 1) dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë (çështja nr. 2) dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër si dhe gjyqtarët e seksionit penal të kësaj gjykate që janë caktuar më herët ose që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: z. Arbër Çela, z. Tonin Stërkaj, znj. Luveda Dardha dhe z. Besmir Stroka (çështja nr. 1), si dhe të përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, konkretisht znj. Ornela Naqellari (çështja nr. 2).

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Sokol Shehu, i cila caktohet për të gjykuar çështjen e parë të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe gjithashtu përzgjidhet gjyqtari Jak Ndoka, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e parë të veçantë

në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: z. Desart Avdulaj.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Tritan Hamitaj, të cilët caktohen për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Gjyqtarët duhet të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën 5 vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këto gjyqtarë janë: Enton Dhimitri, Margarita Buhali, Artur Kalaja, Astrit Kalaja, Dritan Banushi, Manjola Xhaxho, Alma Kolgjoka, Ornela

Naqellari, Esmeralda Çeka, Rexhep Bekteshi. Ndërkohë janë edhe dy gjyqtarë të tjerë të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por nuk kanë të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, ata janë Asim Vokshi dhe Regleta Panajoti.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Alma Kolgjoka, e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

**(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)**

**(Mbajtur, më 30.03.2020)**

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 15:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

- 9. Brikena Ukperaj* (anëtar)  
*10. Erjon Muharremaj* (anëtar)  
*11. Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*  
*2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*  
*3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relaton shkurtimisht relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ndër të tjera, zoti Toska shprehet se me fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është emërtuar Gjykatë e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Pas kësaj vendimmarrjeje, në përmbushje të kushteve dhe kriterëve ligjore, Këshilli ka caktuar në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjyqtarin z. {...}, për të cilin ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e tij në detyrë.

Më tej, shton zoti Toska, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më datë 05.03.2020 ka vendosur “Shkarkimin nga detyra” të këtij subjekti, prandaj mbi këtë bazë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin në fjalë duke i propozuar Këshillit:



- Deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe transferimin e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke filluar nga data 06.03.2020 deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij nga KPA-ja.

Në përfundim, zoti Toska lexon projekt-aktin e përgatitur si më poshtë:

1. Deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Transferimin e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke filluar nga data 06.03.2020 dhe deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas Ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, gjyqtari z. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritët të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja "b", e Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.  
Brunilda Kadi është dakord.  
Dritan Hallunaj është dakord.  
Iilir Toska është dakord.  
Alban Toro është dakord.  
Fatmira Luli është dakord.  
Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është kundër.  
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi miratimin e projektvendimit “Për deklarin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 30.03.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e nismës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë”, përgatitur nga Komisioni Përkohshëm i ngritur për këtë qëllim.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 15:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

*10. Erjon Muharremaj* (anëtar)

*11. Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e nismës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë”, përgatitur nga Komisioni Përkohshëm i ngritur për këtë qëllim.

Fillimisht merr fjalën Kryetarja e Këshillit e cila bën një përmbledhje të aktit të përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i cili ka studiuar dhe i ka sjellë për propozim Këshillit një sërë masash për uljen e backlog-ut në Gjykatën e Lartë dhe kjo nëpërmjet një Memorandumi Mirëkuptimi, Memorandum i cili është realizuar me asistencën e Projektit “Drejtësi për të gjithë” ku masat të cilat propozohen nëpërmjet këtij Memorandumi, janë masa të cilat do të mbështeten nga ky projekt. Për relatinin e këtij akti, fjalën e merr zoti Medi Bici, kryetar i Komisionit të Përkohshëm.

Zoti Bici, lexon relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për miratimin e nismës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë”. Ndër të tjera, në vazhdim edhe të fjalës së Kryetares së Këshillit, zoti Bici shprehet se Memorandumi i Mirëkuptimit (i lartpërmendur) mbështetet në tre prioritete kryesore, të cilat janë: Trajtimi nëpërmjet veprimeve të menjëhershme të çështjeve të prapambetura; Parandalimi në të ardhmen i krijimit të çështjeve të prapambetura; Ndërgjegjësimi i publikut, duke mos bërë rekurs çdo lloj çështjeje por vetëm atëherë kur rekursi është parashikuar shprehimisht në ligj.

Më tej zoti Bici vijon me qëllimin strategjik që u përket të tre palëve, pjesë e këtij Memorandumi, që është bashkëpunimi për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e akumulimit të mëtejshëm të numrit të tyre, si dhe zbatimin e praktikave më të mira për menaxhimin e lëvizjes së çështjeve.

Sa i përket relatimit më tej të çështjes, duke qenë se linja e zotit Bici ndërpritet për shkak të mosfunksionimit të internetit, atëherë anëtarët e tjerë të Këshillit bien dakord që ta vazhdojnë çështjen pa u vazhduar më tej relatimi sa i përket përmbajtjes së Memorandumit, për shkak se ata janë të gjithë të njohur me materialin.

Më tej anëtarët kalojnë në diskutimet dhe sugjerimet që kanë në lidhje me çështjen në fjalë, ku fillimisht **zonja Brunilda Kadi** kërkon që gjatë zbardhjes/redaktimit përfundimtar të Memorandumit të Mirëkuptimit të saktësohet ndonjë datë për t'u përditësuar me momentin e miratimit.

Më tej edhe zoti **Alban Toro** shprehet se në Memorandum duhen shtuar edhe dy data, si ajo e kohëzgjatjes së Memorandumit (B. Kohëzgjatja dhe ndryshimi) dhe tek Seksioni 3 pika 6 gjithashtu është për t'u vendosur një datë.

Në përgjigje të zotit Toro, zonja Kadi shprehet se do të jetë pa afat i) për arsye se nuk duhet si do të shkojë situata si dhe ii) deri ku do t'i ketë mundësitë Projekti.

**Zonja Naureda Llagami** propozon që të vendoset vetëm data e miratimit të Memorandumit (që është data e sotme) ndërsa për momentet e tjera mos të vendoset datë.

**Zoti Toro** është i mendimit që, nëse do të lihet pa afat, duhet të rregullohet teksti në Memorandum (pra bëhet fjalë për Seksionin 3, pika 6 me tekst "Pritshmëria është që kontratat e punës të mbulojnë një periudhë \_\_\_\_ (periudha është lënë bosh)...") ose propozon që minimalisht ajo duhet të jetë 1 vit sepse marrëdhënia midis të tre palëve duhet të jetë e qëndrueshme.

Zonja Kadi në vijim të fjalës së zotit Toro mendon që vënia e afatit ka të bëjë me disponibilitetin e Projektit, pasi këtij Projekti i përfundon afati në fillim të vitit tjetër dhe prandaj sugjerohet që të lihet bosh.

*Zonja Brikena Ukperaj* gjithashtu sugjeron që titulli i Memorandumit, për nga përmbajtja dhe për arsyet që çojnë në nënshkrimin e tij, do të shkonte më tepër të ishte Memorandum Bashkëpunimi.

Në sqarim të kësaj zonja Kadi shprehet se janë specialistët e Projektit që e përdorin këtë gjuhë, por nëse ka anëtarë që mendojnë që termi të ndryshohet, le të diskutohet.

Anëtarët janë të mendimit që termi i përdorur në titullin e Memorandumit të qëndrojë siç është propozuar nga Komisioni përkatës.

Në përfundim, pas diskutimeve, anëtarët bien dakord në parim mbi përmbajtjen e Memorandumit të Mirëkuptimit të propozuar nga Komisioni i Përkohshëm i ngritur për këtë qëllim, bashkë me sugjerimet të cilat u diskutuan si, saktësimi i muajit mars në fillim të Memorandumit dhe pasi të qarkullojë midis anëtarëve për t'u saktësuar të gjitha, më pas do të firmoset.

Pas rifutjes në linjë nëpërmjet programit të asistuar nga specialisti i EURALIUS, zoti Bici propozon përpara anëtarëve të Këshillit projekt-aktin për miratim, si më poshtë:

1. Miratimin e nismës për uljen e numri të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë sipas propozimit të Projektit “Drejtësi për të gjithë” të USAID.
2. Miratimin e përmbajtjes së Memorandumit të Mirëkuptimit që do të lidhet për qëllimin e kësaj nisme sipas tekstit bashkëlidhur.
3. Autorizimin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor për të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Përkohshëm për Hetimin e një Plani Veprimesh lidhur me reduktimin çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Zoti Ilir Toska** merr fjalën dhe është i mendimit që pika 4 e projekt-aktit të hiqet pasi Komisioni është pjesë e Memorandumit/marrëveshjes.

Më pas, **zoti Medi Bici** është dakord me mendimin e zotit Toska si dhe sugjeron që në pikën 3 të zëvendësohet fjala “Autorizimin e Kryetares” dhe të vendoset “Ngarkohet Kryetarja”.

Në përfundim edhe të sugjerimeve hidhet në votim fillimisht propozimi i zotit Toska që të hiqet pika 4 e projekt-aktit, propozim i cili miratohet nga anëtarët e Këshillit, ndërsa propozimi i zotit Bici nuk miratohet, dhe më pas hidhet në votim i tërë projekt-akti me ndryshimin e bërë (pra heqjen e pikës 4), dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi miratimin e projekt-aktit “Për miratimin e nismës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë”, si më poshtë:

1. Miratimin e nismës për uljen e numri të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë sipas propozimit të Projektit “Drejtësi për të gjithë” të USAID.

2. Miratimin e përmbajtjes së Memorandumit të Mirëkuptimit që do të lidhet për qëllimin e kësaj nisme sipas tekstit bashkëlidhur.

3. Autorizimin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor për të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 30.03.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i komisionit që do të përgatisë komentet për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 15:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Caktimi i komisionit që do të përgatisë komentet për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021”.

Sa i përket çështjes në fjalë, Kryetarja e Këshillit sqaron se bëhet fjalë për një shkresë e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës më datë 12 mars e cila bën fjalë për kandidatët e profilit magjistrat që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar për vitin akademik 2020-2021, për të cilët Këshilli duhet të japë komente dhe sugjerime lidhur me listat e kandidatëve që kanë plotësuar dhe që nuk kanë plotësuar kriteret ligjore.

Për këtë arsye, është shtruar kjo çështje për diskutim nga Kryetarja e Këshillit, pra sa i përket caktimit të Komisionit që do të merret me përgatitjen e komenteve për raportin e Shkollës së Magjistraturës.

**Zoti Ilir Toska** merr fjalën për të shtuar se në pikëpamje formale kjo çështje ka nevojë për vendimmarrje, pasi raporti që do përpilojë ky Komision, duhet të miratohet në Këshill.

**Zonja Brunilda Kadi** merr fjalën më pas për të shtuar edhe faktin se në çfarë shtate gjendet Këshilli dhe se do të jetë e vështirë aksesimi i gjithë atyre dosjeve dhe nuk është dakord që këtë raport ta përpilojë i njëjti Komision që e ka pas edhe vjet. Gjithashtu, zonja Kadi ngre edhe një problem tjetër që është ai i ankimimit të ndonjë

vendimi skualifikimi nga ana e tyre dhe ku aktualisht gjykatat nuk punojnë. Zonja Kadi më pas jep edhe mendimin se Komisioni që duhet të caktohet për këtë qëllim mund të jetë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Pas fjalës së zonjës Kadi, merr fjalën **zoti Toro** i cili është i mendimit që Komisioni që duhet të përgatisë komentet të jetë i njëjti Komision që ka punuar edhe vjet, për të ruajtur edhe standardin ose të krijohet një Komision Ad Hoc. Por në përgjigje të kësaj, zonja Kadi shprehet se standardi i vjetshëm ka qenë mbi baza vullnetare.

Gjithashtu edhe **zonja Marçela Shehu** sugjeron që kjo çështje mbase duhet të diskutohet në një moment tjetër, mbasi të vendoset data e provimit, duke qenë se asnjë nga anëtarët nuk mund të aksesojë dosjet në këtë moment. I të njëjtit mendim me zonjën Shehu është edhe **zoti Dritan Hallunaj**.

Duke qene se **zoti Muharremaj** ka marrë pjesë në Mbledhjen e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, ka dijeni për dy propozimet që Shkolla jep për zhvillimin e testimit: njëri propozim është që të shtyhet testimi për në datën 20-22 maj dhe propozimi tjetër nëse nuk e lejon situata këtë datë, të shtyhet për 20-22 qershor. Edhe zoti Muharremaj është i mendimit që të shtyhet dhe të shqyrtohet në një moment tjetër pasi edhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës të marrë vendim.

Pas diskutimeve dhe sugjerimeve të disa anëtarëve, hidhet në votim shtyrja e kësaj çështjeje nga Kryetarja e Këshillit, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Me këtë çështje të rendit të ditës përfundon mbledhja e datës 30.03.2020.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**